

PËLLUMB KULLA  
**LAMTUMIRË KOMANDANT!**  
ROMAN

---

BOTIMET TOENA



PËLLUMB KULLA

LAMTUMIRË KOMANDANT!

roman

(Shumë romane në një)

BOTIMET TOENA

Tiranë

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktor letrar: Roland Gjoza

Përkujdesja grafike: Elsa Hajderaj

Kopertina: Pano Kondo

ISBN 9789928376800

© Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjete apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

**BOTIMET TOENA**

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: [botimet.toena@gmail.com](mailto:botimet.toena@gmail.com)

[toena.porosionline@gmail.com](mailto:toena.porosionline@gmail.com)

<https://toena.al>

*Ky është botimi i tretë. Dy botimet e mëparshme,  
ai i vitit 2008 dhe 2016, mbanin titullin  
“Vdekja e Enver Hoxhës”.*



KREU I PARË

FYTYRA E TË VDEKURIT

*Rrëfim i një grimiori*





Kur tingëlloi zilja e portës, mua as që më shkonte ndër mend që ai kish vdekur dhe pas gjysmë ore do ta shikoja me sytë e mi, të pajetë, të shtrirë sa gjatë, nën një çarçaf të bardhë.

Xhulja nuk kish arsye t’i binte ziles, por ajo është dembele e përton të rrëmojë në çantën e saj për të gjetur çelësin. Ajo do të kish marrë Ditin nga kopshti i fëmijëve, do të kish bredhur dyqaneve të blinte dhuratën për kushërirën e saj të parë, që do të martohej në fund të javës dhe tani ashtu e ngarkuar po priste t’i hapja portën.

Atë mbrëmje ne do të festonim për vete. Kishim shtatëvjetorin e martesës sonë dhe të dy ishim përgatitur për këtë. Do ta festonim brenda kuvlisë sonë të ngrohtë dhe nuk do të kishim asnjë të ftuar. Bile, ishim të sigurt se edhe të paftuar nuk do të kishim, ngaqë askush nuk na e mbante mend ditën e martesës. Do ta festonim ngushtë, të tre: Xhulja, unë dhe Diti që atë kohë sapo pati mbushur tri vjetët.

Vajta të hapja portën duke u kujdesur që shigjeta, që mbante në bisht emrin e Xhuljas, të ishte në pozicionin e duhur. Fantazia ime nuk më kish ofruar një shaka më cilësore sesa një shigjetë druri të prodhuar në zdrukthëtarinë tonë të studios së filmit “Atdheu sot”, të këputur më dysh, me bishtin përpara zemrës sime dhe majën të dalë prapa kurrizit, që të jepte përshtypjen se shigjeta dashurore më pat

çarë zemrën e pat dalë tejteje. Kisha veshur një këmishë të vjetër, që nuk më dhimbej aspak, prandaj e pata shqyer para dhe prapa, për t’i bërë vend shigjetës në të hyrë dhe në të dalë. Këmisha fshihte më së miri një rreth plastik të fortë, që më qerthullonte gjoksin e ku një kapëse mbante fort gjysmën e shtizës që ngulej e një kapëse e dytë që mbante, po aq fort në të njëjtën vijë drejtimi, gjysmën që dilte pas. Fytyrën e pata lyer me një ton të zbehtë, që e pata nxjerrë nga valixhja ime e punës në studion e filmit, në mënyrë që të jepja përshtypjen e një njeriu që ka humbur gjak dhe gjendet në orët e fundit të tij.

Me t’iu afruar portës, fillova të rënkoj dhe bëra sikur isha stërmunduar që të arrija deri te kyçi. Me këtë pamje, gjysmë kloun e gjysmë i vdekur, hapa portën:

Te pragu m’u shfaqën tre burra të panjohur që i shoqëronte drejtori i Kinostudios. Ata më panë se si unë, me sy mbyllur e fytyrë të shtrembëruar nga dhimbja, mundohesha të shkëlqoja nga gjoksi shigjetën që më kish hedhur dashuria e Xhuljas.

E lashë komedinë në mes dhe u shfaqta vizitorëve një buzëqeshje, si për t’u kërkuar ndjesë për shakanë që nuk qe përgatitur për ta. Të panjohurve nuk u bëri fare përshtypje pamja ime gazmore dhe shigjeta me emrin e gruas që më pat goditur mu në zemër.

“Bet, këta shokët...” nisi drejtori im.

“A mund të futemi një minutë brenda në korridor?” tha njëri nga të panjohurit, ai më i gjati.

Pyetja ishte fare e kotë, se që të katër ata u futën brenda dhe njëri prej tyre, një biond, që mua m’u duk sikur pat ardhur nga palca e Suedisë, e mbylli portën me shul.

“Ky është grimiori juaj?” pyeti i gjati drejtorin dhe, siç e paskësh zakon të mos i priste përgjigjet, më pyeti edhe mua: “Ti je Betim Bezati?”.

Unë pashë në sy drejtorin.

“Këta shokët, Bet”, më shpjegoi ai me zë të ulët, “kanë ardhur të të marrin për një punë të rëndësishme, lidhur me artin tënd të grimit.”.

Drejtori më thërret rrallë me emrin që përdorin Xhuli, shokët dhe të afërmit e mi. Ky cungim i lehtë e bën emrin të tingëllojë më i ngrohtë dhe shefi po e bënte këtë që të më ulte shqetësimin që më solli kjo vizitë e papritur.

“A ka njerëz veç teje këtu, në shtëpi?” pyeti ai i gjati, që dukej si më i pari ndër të tjerët.

I thashë që nuk kishte. Por përgjigjja ime ishte pa vlerë, sepse ndërkohë, dy të tjerët, pa teklig, kishin hedhur nga një sy nëpër të ndarat e tjera të apartamentit. Mënyrat si ia lejonin ata të drejtën vetes të bënin kontrollë të tilla dhe të më flisnin mua në vetën e parë me një nënçmim poshtërues, ma dhanë të plotë idenë se ç’lloj njerëzish ishin. Aq më tepër, që edhe pse kërkonin grimior, nuk të linin as edhe pikën e dyshimit që ata nuk kishin aspak nevojë për të bërë filma, ose spektakle. Emri im ishte në dhjetëra vepra kinematografike të studios së vetme të vendit, për më tepër unë mbaja titullin e lartë “Artist i Popullit”, por qe e kotë të shpresoja se ndonjëri nga ata të tre do të më njihte, apo të paktën, të kish dëgjuar për mua, si njëri nga profesionistët më të mirë të vendit.

“Do të vish me ne që në këtë çast”, më urdhëroi i gjati. “Na duhesh me ngut. Mund të lësh një letër për familjarët e t’u thuash se do të kthehesh pak me vonesë sonte.”

“Nuk kam familjarë të tjerë veç gruas dhe djalit të vogël. Unë”, ia bëra me zë të mekur, “dua të them, ne, sot kishim dhe përvjetorin e martesës dhe...” Dhe bëra me shenjë nga shigjeta, sikur ajo do të më vërtetonte ato që thosha.

“Ka gjëra më të rëndësishme, se një përvjetor”, tha tjetri prerë.

“Mos lërë asnjë letër, Bet”, më këshilloi drejtori nga ana e tij. “Do ta marr unë Xhuljan në telefon dhe do t’i them që na doli një problem i vështirë në studion e filmit.”

Njëri nga burrat që heshtnin u muar me çmontimin e shigjetës që mezi pata përgatitur. Copat e hequra, suedezi i mori që t’i lëshonte gjëkund, ndërsa unë u futa në banjë të fshija pamjen e meitit, që i kisha dhënë vetes.

Para godinës sonë qëndronte një makinë e zezë, e rëndë, me xhama të errët e goma të gjera, që, veç shoferit, na pranoi edhe ne, pesë të tjerët, në barkun e saj.

Makina lëvizti dhe unë nisa të ndieja një ngërç në fund të kurrizit. Asnjëri nuk pipëtinte. Më dukej vetja si një i porsaarrestuar dhe drejtori, që nuk dija se përse nuk më shikonte në sy, ma bënte më të rëndë përfytyrimin. Vrisja mendjen se ç’punë mund të kishin në studion e filmit këta njerëz dhe përse u duhesha unë. Nga ana tjetër, përse duhej të vinin këta, teksa çdo automjet i Kinostudios mund të vinte dhe të më merrte me urdhrin e çdo lloj administratori, pa qenë fare nevoja, që për këtë, të thirrej e të merrte mundimin drejtori i përgjithshëm. Por mungesa e respektit që ata tre burra shfaqnin edhe me të, vetëm m’i shtonte pyetjet, që fantazia ime e lodhur nuk u jepte dot përgjigje.

“Ja, këtu mund të zbres unë”, propozoi befas drejtori.

“Ndale!” urdhëroi i pari shoferin. “Ju faleminderit, shoku drejtor. Na falni për shqetësimin.”

Ishin të vetmet fjalë të sjellshme që kisha dëgjuar deri atë çast, por akoma as edhe një të tillë në adresën time. Duke zbritur, drejtori më siguroi edhe njëherë se do t’i telefononte Xhuljas dhe më la mua në shoqërinë e atyre njerëzve hijerëndë që nuk i pata parë kurrë ndonjëherë.

Makina u vu përsëri në lëvizje. Po ngjitim rrugën e Rrepëve dhe unë shikoja njerëzit që shëtisnin të qetë në atë buzëmbremje prilli. Kur iu afruam Kinostudios “Atdheu Sot” unë e mundova veten edhe me një pyetje tjetër: përse nuk erdhi tok me ne drejtori?! Kur roja nderoi me një servilizëm të tepruar, e mora me mend që kjo makinë, me dritare të errëta, paskësh qenë këtu para se të ma gjente mua shtëpinë. Makina u drejtua nga ana e pasme e ndërtesës së madhe dhe ndaloi pranë ateliesë kryesore.

“Tani zbrit edhe merr kutinë, a çantën, a çfarë ke ti, me mjetet e tua të punës. Ne të presim këtu”, më urdhëruan.

“A mund të më thoni diçka më shumë? Që ta di se çfarë të marr.”

Pyetja ime iu duk e vështirë kryetarit të grupit të shoqëruesve.

“Merr gjithçka ke! Merri të tëra mjetet e tua. Sa më shumë. Po t’u nevojit ndonjë gjë, që nuk do ta kesh marrë, të sjellim përsëri.”

U ngjita në zyrë. Përgatita valixhen, njësoj siç bëja me xhirimet në terren. Kontrollova serinë e toneve, llakët, ngjitëset. Futa brenda tërë serinë e parukave, mustaqeve dhe të mjekrave dhe pas dhjetë minutash u gjenda përsëri

në makinë, pa asnjë dyshim, me fytyrën më të hutuar të gjithë jetës sime.

“Çdo gjë në rregull!” u raportova.

Makina mori rrugën e kthimit, përshkoi tatëpjetë rrugën e spitalit, mori unazën në drejtim të lumit, doli në Bulevardin e Madh dhe iu drejtua korpusit qendror të Universitetit. Që nga xhami i parë dukej që në sheshin para korpusit kish mizëri njerëzish. Bënin prova. Prej ditësh flitej për një koncert të madh rinor. Thoshin se do të merrte pjesë edhe i pari i vendit, Komandanti.

Do të habitesha shumë po të nevojitesha për të përgatitur këngëtarët e koncertit!

Hamendja ime e parë u rrëzua se automjeti ynë nuk arriti atje, por ktheu në postbllokun e banesave qeveritare. Ndaloi vetëm një grimëherë para ushtarëve të gardës dhe mjaftoi vetëm një shenjë e shoferit, që ne të vazhdonim rrugën. Nga dritarja, që e hapi shoferi, brenda në makinë futej me uturimë të përforcuar nga altoparlantët, zëri i këngëtares:

*“Kush më merr mua  
Merr yll, jo grua!...”*

Atë çast u kujtova që e kisha harruar fare Xhuljan dhe përvjetorin tonë të martesës.

Kënga na shoqëroi edhe pas një ndërtese, nëpër ca shkallë që të shpinin në katin e saj të nëndheshëm. Burri i gjatë, që më pat hequr nga festëza e martesës, më shoqëronte. Dy të tjerët mbetën në makinë. Ishte hera e parë që futesha në lagjen e famshme, ku jetonin rangjet e larta të drejtuesve të vendit. Atë kohë flitej shumë për luksin që mund të shihej atje, por pamja e parë që po më shfaqej mua sapo shkela në të, ishte ajo e një bodrumi. Në bodrum gjetëm nja katër

vetë me rroba të bardha, që seç diskutonin pranë një njeriu të shtrirë e të mbuluar me një çarçaf, që m'u duk i lagur. I tërë trualli i katit të nëndheshëm ishte i lagur. Çarçafi linte të dukeshin qartë format e njeriut që dergjej aty i vdekur, i lënë krejtësisht pa vëmendjen e mjekëve. Mjekët me rroba të bardha nuk shfaqën asnjë interes edhe me hyrjen tonë. Kurse një burrë me mustaqe, trupngjeshur e i veshur mirë, u nda nga ata dhe na doli përpara. Ma zgjati dorën në heshtje, priti sa ta kaloja unë valixhen në dorën tjetër, që t'i shtrëngoja të tijën dhe e pyeti shoqëruesin nëse më kishin treguar se përse po më thërrisnin. Kur shoqëruesi im, me atë fytyrë të ngrysur, i tha jo, burri që na priti nuk e qortoi aspak.

“Mirë keni bërë”, tha burri që dukej se ish epror i tij. “Nuk e shikoni sa i zbehtë është ende pa ia thënë?!”

Më futi krahun dhe më mori në një të ndarë aty pranë. Ishte një dhomë e mobiluar mirë, si të thuash, një mjedis i këndshëm çlodhës. Kolltukët ishin të fismë dhe një banak ishte i mbushur me shishe pijesh të ndryshme, që menjëherë dukeshin që ishin nga importi. Burri më ftoi të lija valixhen dhe të ulesha. U ula dhe në pasqyrë pashë një njeri të zbardhur në fytyrë e me sy të çapëlyer. Në kohën që burri po mbushte një gotë, unë pata aq hapësirë sa të përmblidhesha e ta njihja atë njeriun me sy të çapëlyer, që nuk paskësh qenë askush tjetër veçse unë vetë. Burri që më pat sjellë, rrinte më këmbë te dera e dukej sikur kishte humbur gojën.

Eprori ma zgjati gotën e mbushur mua.

“Pije”, më tha, “të mbledhësh veten.”

E mora mekanikisht gotën dhe e afrova te goja. Ishte një pije e fortë e paprovuar ndonjëherë.

Shoqëruesi im kërkoi leje.

“A mund të largohem një copë herë, shoku Telo?” pyeti burrin që më ofroi pijen.

“Largohu, por vetëm për pak. Mund të na duhesh. E këtej e tutje, lejen do t’ia kërkosh shokut Betim. Ky do të jetë eprori yt këto ditë.”

“Si urdhëron! Si urdhëron!” përsëriste me servilizëm shoqëruesi gjatë fjalës së Telos. Pastaj m’u kthye mua. “Shoku Betim, me lejen tuaj?”

Unë ia bëra po me kokë dhe nuk e shijova aspak gradimin, si superior i tij. Nuk po e kuptoja as kohëzgjatjen e detyrës sime, për të cilën foli Teloja dhe as thelbin e punës që duhet të bëja me valixhen e mjeteve të makijazhit. E gjithë kjo atmosferë me të vdekur, me mjekë dhe me shoqërues, që befas, nga harbutë shndërrohen në servilë, më kish lënë pa mend. Por mbi të gjitha, ai, i vdekuri! Atje! I mbuluar me çarçaf! Brrrrr!

Shoqëruesi na la vetëm. Njeriu që kisha përpara e që më sodiste kur unë ngrija gotën, kish një fytyrë me ton të errët sikur ruante ende kujtimin e plazhit të verës së vjetshme. Mustaqet ishin gjëja më e hijshme që kish ai në sipërfaqen e fytyrës së tij. Ai ma dha njoftimin që në gllënjikën e dytë.

“Duhet të ta themi dhe ty një lajm të hidhur që pak e dinë:

Komandanti ynë i lavdishëm nuk është më! U nda nga ne! Na la!”

Mua m’u muar fryma. Sikur m’u shemb tavani përsipër.

“Komand... Koman...”, përsërisja unë i mekur.

“Po, po”, tha Teloja. “Gjëmë e madhe u gremis anekënd mbi atdheun tonë. U nda nga gjiri ynë. Ja, siç e pe, atje, nën çarçaf!”



Unë kisha ngrirë i tëri.

“Këtë gjë e di vetëm familja. E dinë anëtarët e Byrosë Politike. Dhe ata, jo të gjithë. Vetëm Kryesia e saj. E kupton? Askush tjetër.”

“Mjekët?!” më shpëtoi pyetja mua.

“Më të besuarit”, plotësoi ai. “Kirurgu që bëri zbrazjen e barkut, nuk e di as tani, se cili është i vdekuri. Ai nuk e di se kujt ia hoqi të brendshmet. Ne i hapëm dhe i shfaqëm atij vetëm pjesën që i duhej për punë. Ty po ta themi të fshehtë, se na duhesh. Atdheu përgatitet. Lajmi nuk është i lehtë. Armiqtë e brendshëm dhe ata të jashtëm duhet ta marrin këtë lajm atëherë, kur gjithçka të jetë bërë gati, që jeta e vendit dhe fatet e popullit të mos kenë asnjë rrezik, edhe pa shokun Komandant. E kupton tani, se çfarë lloj të fshehte të kemi besuar ty?”

Unë, i mekur, vazhdoja të tundja kokën për të shprehur *po-të*, që s’i nxirrja dot, ngaqë mund të më linte zëri. Të vetmen po, e thashë njëzet herë, atëherë kur Teloja që nuk e dija se cili ishte dhe përse kishte marrë përsipër tërë drejtimin e këtyre punëve, ma kërkoi atë medoemos.

“Do të zotohesh këtu përpara meje, pa qenë nevoja për firma dhe vula, që në këto katër a pesë ditë, që do të punosh me pamjen e fytyrës së tij, nuk do t’i thuash as edhe një njeriu, që i Pari i Vendit ka vdekur? Ëh? Të zotohesh, që kjo e fshehtë nuk do të të shpëtojë as edhe në gjumë, me veshin e nuses në të njëjtin jastëk, ëh? Jemi shtrenguar të ta zbulojmë ty sekretin, ngaqë do të na nevojitesh të punosh me fytyrën e tij, se meritë tjetër nuk ke. Ama, për gjakun e shokëve të rënë, në rast se zotohesh...”

Befas e la frazën në mes dhe me një ashpërsi moskokëçarëse m’u shkreh drejt e në të bardhat e syve:

“Zotohesh, nuk zotohesh, xhanëm! Vumë re se të ka shpëtuar sekreti, luan me jetën tënde dhe jetët e njerëzve të tu më të dashur! Pa burg, pa gjyq! E unë betohem për kujtim të Komandantit dhe po e theksoj, për gjakun e shokëve, këtë kërcënim, unë e bëj edhe realitet. Thuana tani, zotohesh?”

“Po.”

Me këtë kërcënim, të qetë por të egër, unë nuk kisha asnjë besim se do të punoja pa m'u dridhur duart, aty e gjatë njëqind vjetëve që do të vinin më pas. Llahtara ime ishte bërë lebeti. Lëre mënjanë fytyrën e të vdekurit, që do të shihja pas pak, por unë nuk dija se ç'bëhej atëças me fytyrën time. Të dyja kisha frikë t'i shihja, por nuk kisha se si të shpëtoja pa i parë. Sidomos atë të atij!

Teloja, burri me atë lëkurën e pjekur nga dielli, vendosi të më linte për ca kohë vetëm; të qetësohesha. Para se të tërhiqte derën nga vetja, më bëri me dije se makina që më pat sjellë dhe grupi që më shoqëroi, gjatë këtyre ditëve, do të ishin nën urdhrat e mi. Makina do të më shpinte në shtëpi, por do të më linte gjithnjë diku larg godinës ku banoja dhe një copë rrugë do të më duhej ta bëja në këmbë. Edhe kur të vinin të më merrnin do të duhej të përshkoja më parë një pjesë rruge në këmbë, larg nga banesa, sipas nevojës, por asnjëherë në një vend. Në ato ditë unë nuk do të merrja urdhra nga asnjëri, as nga anëtarë të Byrosë Politike dhe as nga pjesëtarë të familjes së Komandantit. Do të përgjigjesha vetëm para bashkëshortes të të ndjerit dhe Telos.

Ai, ca e nga ca, më theksonte rëndësinë time, qoftë edhe të përkohshme, por kjo mua nuk më bënte ta ndieja aspak veten më të rëndësishëm. Më dukej vetja si një ballon që sa më shumë fryhet, aq më tepër lehtësohet dhe aq më

gradualisht rrezikon të pëlçasë nga çasti në çast. Në ato pak minuta, që ai më la të qetësohesha, unë e mblodha vërtet veten dhe nisa të bindem se aty nuk më kishin sjellë aftësitë e mia në trajtimin e fytyrave të njerëzve, që lozin për kinemanë, a për teatrin, apo që përgatiten të përcillen me nderime, siç ishte ky rast historik. Edhe të tjerë, me siguri, dinin ta bënë këtë, edhe më mirë se unë, bile. E pleqësova me mendjen time se unë isha përzgjedhur më së shumti për merita të gjyshit tim, që pat qenë mik i vjetër me Komandantin, qëkur qëndronin bashkë në rrethin e ngushtë të Shtabit të Përgjithshëm, në vitet e luftës partizane. Dhe këtë ma zbuloi e shoqja e Komandantit, vejushë tashmë, në një nga ditët më pas, kur unë këshillohesha me të për trajtimin e pamjes së të vdekurit, në përgatitje të homazheve gjithëpopullore, që po organizoheshin me kujdes, ende pa u dhënë lajmi i vdekjes. Një tjetër grimior me rrënjë politike më pak të lidhura me revolucionin, nuk mund të jepte garanci në detyrimin e rëndë të fshehtësisë, që më theksoi njeriu me ato mustaqet në atë fytyrë të zeshkët.

Me gotën në dorë shkova vetë në banak dhe shtira edhe pak pije. Nuk e di nëse e mora pijen po nga ajo shishe, nga e cila më hodhi Teloja, se nuk e mbaja mend shijen e pijes së parë dhe nuk po dalloja as shijen e së dytës. E vetmja kënaqësi që pata, nuk kish lidhje me shijen: vura re që dora nuk më dridhej siç kisha pasur frikë aty ca çaste më parë.

Pastaj iu afrova derës prej nga doli Teloja, e hapa dhe hodha vështrimin në sallën ku qe vendosur ai, i vdekuri i madh.

Pamja që m'u shfaq para syve ishte edhe më e llahtarshme se atëherë kur hyra. Në këtë hapësirë të nëndheshme nuk kish mbetur as edhe një qenie e gjallë. Nuk ishin më doktorët, nuk ishte Teloja. Aty tani ndodhej vetëm trupi i Komandantit, i mbuluar me çarçafin e bardhë, i lënë vetëm, si i harruar, si i braktisur, si një objekt që nuk rrezaton më as autoritet, as frikë. Frika ishte aty në ajër, por ishte një frikë e një lloji tjetër. Ishte ajo e njohura e vjetër, që nuk më ndahej netëve të fëmijërisë, kur ndonjë i afërmi ynë vdiste dhe unë e përfytyroja se do të më shfaqej sapo të isha vetëm. Ja, tani isha vetëm me një tjetër të vdekur, por po aq të frikshëm, sa ata që më rrinin pezull në errësitat, që më dukeshin pa fund tek më merrej fryma nën jorgan. Ishte një i vdekur madhor ky, një njeri që tani mund të ngrihej, të flakte çarçafin dhe të më thoshte me zë të rëndë: “Cili je ti, mo?”.

E mblodha veten edhe njëherë. Lashë përfytyrimet dhe pa e kthyer më kokën nga trupi i shtrirë i udhëheqësit të vdekur, dola nga nëndheu dhe ngjita shkallët që të shpinin në lartësinë e oborrit.

“Një–dy–tri–katër! Prova teknike: një–dy–tri–katër!” Jehona vinte nga altoparlantët e sheshit të universitetit, nga përgatitjet e koncertit të nesërm. (“Ku flitej se do të asistonte dhe Komandanti!” shtova me mendjen time çapraze, që më habiti sesi punonte edhe për ironi të tilla, të hidhura.)

Në oborrin e pasmë vura re njërin nga ata mjekët. Ai pinte cigare pa u ngopur, duke e thithur tymin e duhanit me nervozizëm, si i babëzitur. Sa më pa, e shkeli me nxitim cigaren e porsandezur me majën e këpucës dhe gati vrapoi tek unë.

“Më falni”, më tha duke më zgjatur dorën. “Jam Çapajev Hyka, kirurg.”

Ia shtrëngova dorën që më zgjati.

“Betimi...”, ia ktheva dhe aty më piku në mend, se ishte gjyshi ai që ma pat zgjedhur emrin. Ndofta për kujtim të heronjve a personazheve të luftës me guerilje, ashtu i frymëzuar nga epopeja e luftës për çlirim. Po gjyshi i këtij, Çapajevit, a jetonte ende? Në cilën brigadë, vallë, do të kish bërë pjesë gjatë luftës? Në cilin qytet të Bashkimit Sovjetik ish dërguar pas luftës, për specializim?

“Ju do t’i trajtoni fytyrën?” më pyeti kirurgu.

“Kujt?” dhe padashur vështrova përqark

“Komandantit të vdekur”, tha ai duke e ulur zërin për t’u marrë vesh ashtu siç desha unë. “Ju pushë kur ju sollën qëparë. Thanë që ju do të përgatisni pamjen për ditët që populli do të vijë t’i japë lamtumirën.”

Dhe si duket e ndjeu, që unë isha fanatikisht i mbyllur, sepse më ofroi menjëherë më shumë mirëbesim.

“Ne do të punojmë bashkë. Ju thashë, unë jam kirurg. Bile unë kam filluar nga puna”, më rrëfeu gati me pëshpërimë.

Me këtë njeri mund të bisedoje. Papritur, Çapajevi m’u bë i afërt. M’u duk aty për aty si zbulimi i nevojshëm i një vatre të ngrohtë. Kur e di që nuk do të bisedosh për ngjarjen e madhe me gruan dhe me shokët më të ngushtë, ky anëtar i familjes së re të atyre ditëve, të duket edhe i dashur. Unë që, si iriqi, isha bërë shuk me gjemba, u hapta menjëherë.

“Ti e bërë zbrazjen e trupit?”

“Jo. Unë s’jam për ato punë. Ishin katër specialistë. Thirrën dhe një të pestë. Për abdomenin. E sollën nga Spitali i Ushtrisë. E shpunë tek i ndjeri duke e mbajtur për dore, me sy të lidhur. Ia zgjidhën, domosdo, që të kish mundësi të punonte. Kur mbaroi, ia lidhën përsëri dhe ai, ashtu, me

sy të lidhur, kur po e nxirrnin, nderoi me grusht dhe tha: ‘të rrojë partia dhe Komandanti ynë i lavdishëm!’ Ishte i bindur që kishte vdekur një njeri i rëndësishëm, po se cili?!..”

Ai m’i thosh gjithë këto hollësi për të krijuar më shumë afërsi me mua, por gjithsesi, po më dukej i terrorizuar dhe kjo nuk më la as mua të buzëqeshja, me përfytyrimin e asaj ngritje të grushtit në lartësinë e syve të lidhur. Ai më besoi menjëherë hallin e tij. Kishte shpresë se unë do ta ndihmoja. Pat bërë një gafë profesionale. Kish tentuar t’ia tërhiqte pak lëkurën e fytyrës, për sheshimin e rrudhave, por lëkura e të vdekurit ishte shumë e strepsur dhe nuk i bindej në tërheqje. Ai kish vënë re se të gjitha përpjekjet e bënin gjendjen edhe më pa shpresë dhe, e prera që kish bërë, hapej gjithnjë e më shumë.

“Po eja! Eja të ta tregoj konkretisht atje!” m’u lut gati duke qarë.

Dhe duke zbritur me ngut shkallët, që të shpinin në sallën e nëndheshme, më fliste për veten me një fije zëri, gati me pëshpërimë.

Njësoj si unë, ai paskësh bërë një stazh të plotë në Paris. Ishte specializuar për operacione plastike dhe kish emër të mirë në rrethin e grave të lagjes së udhëheqësve.

“Por, më beso, tjetër është lëkura e njeriut të gjallë dhe tjetër është ajo e të vdekurit. Për ideal, e tmerrshme! Të lutem, shoku Betim, ndihmomë! Ma hiq litarin! Kjo është ngjarja më e llahtarshme që më ka goditur në jetë. Jo, jo. Nuk flas për humbjen e shokut Komandant. Kjo, po se po! Flas për problemin që më ka ndodhur mua. Rrezikoj shumë, më beson? Për ideal!”

Dhe ndërkohë më kishte shpënë përpara Komandantit, që vazhdonte të dergjej shtrirë sa gjatë, mbuluar me atë çarçafin e lagur.

Mjeku zgjati të dyja duart dhe me një shpengim, që unë nuk ia mendoja dot vetes, ia zbuloi fytyrën.

Portreti që më goditi sytë ngjallte llahtarë. Nuk mund të përqsasja kollaj fytyrën më të njohur të jetës sime, atë fytyrë që më qe shfaqur përditë dhe nga shumë herë gjatë tërë viteve që unë ndodhesha mbi këtë hise të rruzullit; fytyrën më të kudogjendur, në muret, posterat, ekranet, në morinë e gazetave, në pullat postare, në faqet e maleve; fytyrën, për të cilën, ishte përdorur aq shumë mermer, allçi, bojëra, beton, zaje lumi, trupa njerëzore të veshur njësoj në shkallë stadiumesh; jo, nuk mund ta përqsasja dot, me atë fytyrë që kisha përpara tani: të vuajtur, të ligur e të tretur. Ishte një shkretëtirë zbehtësie! Të gjitha eshtrat mbizotëronin pamjen. Hunda, harkatat e vetullave, mollëzat, qoshet e ballit dhe të nofullave, të tëra ngjanin sikur qenë përpjekur të kërcenin përmbi lëkurën e bardhë. E kjo ndeshje e tyre me lëkurën, dukej sikur pat vazhduar derisa frymëmarrja pat reshtur dhe gjithçka ish ngrirë. Buzët mishtore, që mua më binin në sy më shumë nga çdo gjë, kur ai shfaqej në jetët tona të përditshme, edhe ato qenë tretur.

Unë po shihja ëndrrën më të frikshme, atë të paparën ndonjëherë. Aq shumë duhet të isha shpërfytyruar, sa që edhe Çapajevi, që shfaqte vërtet një brengosje të thellë, u tërhoq me respekt përpara efektit që nuk e pat parashikuar se do të shkaktonte tek unë, me atë lëvizje të çarçafit.

Dhe priti sa ta merrja përsëri veten.

“Ja, e shikon? E prera ime është poshtë veshit, por do të bjerë në sy. Nuk mund ta mendoja se do të bëhej dëm kaq i madh!”

“Mos u bëj merak, shoku Çapajev”, e sigurova. “Unë nuk e kam të vështirë ta mbuloj dëmtimin.”

Dhe këtë ia thashë me ngrohtësi. I isha shumë mirënjohës këtij njeriu që më ndihmoi në përballjen me të vdekurin, në mposhtjen e frikërave që më kishin terrorizuar gjatë tërë vegjëlisë.

Por mirënjohja e tij m’u shfaq edhe më e madhe akoma. Ai desh ra në gjunjë, aty, mbi atë truall të lagur. Unë nuk e lashë ta bënte këtë gjë dhe ai, si këmbim, zuri të më puthte duart.

“Hajde ta kuptonte dot atë skenë, njeriu që do të na shihte ashtu!” them tani pas kaq e kaq vjetësh: udhëheqësi i shtrirë dhe dy njerëz, që gati rroken para tij, ndërsa njëri bëhet copë që t’i puthë duart shokut e ky, nuk e lejon!

Por atëças, aty nuk kish një njeri të tretë. I treti ishte, po ai nuk shikonte. Ai kishte ikur tashmë.

Njeriu i tretë, nga lloji i të gjallëve, Teloja, erdhi, disa minuta më vonë. Ndërkohë unë isha njohur me problemet teknike që kisha përpara. Preka në fytyrën e udhëheqësit të vdekur të tërë pikat, ku do të më duhej të vija dorë, natyrisht, pasi të këshillohesha me vejushën dhe me Telon. Nuk pata punuar asnjëherë me një fytyrë të vdekuri. Në prekjen e parë që bëra, ftohtësia më shkaktoi një drithërimë të paprovuar, veçse u binda se problemet me këto lloj portretesh për mua ishin ku e ku më të zgjidhshme. Përqendrimi mbi një tablo të tillë ishte më i lehtë. Kundërshtimi apo ankesat nga njeriu që makijohesh, këtë radhë, do të më mungonin fare.



I vetmi vigjilim do të qe mbajtja e fytyrës së të vdekurit nën kujdes të vazhdueshëm. Njeriu që drejtonte punën më tha, që kufomën gjatë ditëve të homazheve do ta mbanin në zyrën e madhe të njërit prej nënkryetarëve të Parlamentit Popullor. Ai ua kish lëshuar dhomën në duar teknikëve, që tashmë po e shndërronin në frigorifer dhe për këtë atje po punohej me ngut.

“Sa ditë do të zgjasin homazhet?” pyeta. “Dua të them, kur do të organizohet dërgimi në banesën e fundit?”

“Nuk dihet”, ia bëri Teloja. “Nuk është vendosur. Bile as dita e vdekjes zyrtare, ajo kur do të njoftohet populli ynë dhe bota, nuk është caktuar. Shumë pak gjasa ka që atë ta caktojnë sonte.”

Pastaj ai më pyeti për vështirësitë që mund të ndeshnim. E sigurova që çdo gjë do të shkonte mbarë dhe i thashë se do të desha ta lija tronditjen e sotme me kaq. Shpresoja që të nesërmen në mëngjes, të isha në një gjendje më të përshtatshme shpirtërore dhe t’i hyja punës. Do të më duhej që të bëja kujdes për të ruajtur tipare të qeta në pamjen e Komandantit. Përshtypja që duhet të linte fytyra e tij te vizitorët e pikëlluar, duhet të ishte e ëmbël, kështu që ngërçi i çasteve të fundit dhe që vihej re atëças, duhej zhdukur tërësisht. Edhe dobësimi, ajo tretja e frikshme duhej fshehur. Natyrisht, pa e tepruar, se bëhej e pabesueshme pastaj, por disa mbushje duheshin kryer. Unë kisha një lëndë të posaçme, që derdhej butë dhe kollaj mbi kavitetet. Ashtu, efekti i eshtrave që shquheshin aq shumë, do të zbutej. Vetëm në këtë rast puna ime duhej ruajtur me rreptësi. Nuk duhet të lejoheshin kontaktet fizike të familjarëve dhe vizitorëve me fytyrën e të vdekurit.

Teloja më dëgjonte me vëmendje dhe mua më dukej se autoriteti im në sytë e tij po bënte përpjetë. Dukej sikur tani i pari i vendit, ai që për gjysmë shekulli, pat qenë zot i kësaj cope të rruzullit ku lindëm ne, nuk i përkiste më as familjes, as partisë, as udhëheqjes dhe, bile, as atij burri me mustaqe të hijshme, që tani ish gati të bënte menjëherë, pa një, pa dy, çfarëdo që t'i kërkoja unë. Njeriu më i pushtetshëm i vendit, tani, ishte i tëri i imi. Teloja më siguroi, se masat e rrepta të shmangies së kontakteve ishin në dorën e tij dhe kjo do të ishte për njerëzit e tij një detyrë parësore.

Për t'ia shpënë të nesërmen llojet e ndryshme të pamjeve vejushës dhe Kryesisë, kërkova një aparat të mirë fotografik.

“Do ta kesh aparatën”, më siguroi Teloja, “por pa fotograf. Nuk mund t'ia besojmë dhe një njeriu tjetër lajmin e humbjes së Komandantit. Kërkon një angazhim të madh gjetja e fotografit. Do të mundohemi t'i fiksojmë vetë pamjet e fytyrës.”

“Ashtu do të bëjmë!” rashë dakord menjëherë.

Qëlloi një kohë që Çapajevin nuk e mbanin më këmbët nga lodhja dhe shkoi të shtrihej në dhomën ku më patën dhënë lajmin. Telon e thirri dikush, kurse njeriu i gjatë, që më solli nga shtëpia dhe që më tha se e quanin Skënder, më rikujtoi se makina dhe grupi shoqërues prisnin përjashta, të gatshëm të më dërgonin në shtëpi, sapo t'i njoftoja se kisha mbaruar punë.

Mua m'u kujtua edhe një herë përvjetori ynë i martesës, Xhulja, Diti. M'u kujtua dasma që do të bënte të dielën Flora, kushërira bukuroshe e Xhuljas. Unë i kisha premtuar se do të vinim tek ajo dhe me portretin e Florës-nuse do të merresha vetë. Kisha gjetur edhe automjetin që do të na shpinte dhe

sillte, nga ajo dasmë e largët. Tani, dasma, me siguri nuk do të bëhej. Ishte e sigurt që vdekja e Komandantit do të pezullonte shumë festa të atyre ditëve. Dhe më e sigurta nga të gjitha, ishte që unë, sidoqoftë, nuk do të udhëtoja dot dhe nuk do t'i mbaja premtimin Florës së bukur.

Të gjitha këto më vinin në mend ashtu siç isha; shpirtvlarë, para trupit pa jetë të Komandantit. Isha vetëm me të. Tani u mësova me praninë e tij dhe nuk kisha aspak atë ndjenjën e llahtarisë së viteve të fëmijërisë. Dukej sikur atë tani ma kishin dorëzuar mua.

Solla ndër mend pamjen e parë, kur ata burrat me mantele të bardha i kishin kthyer kurrizët dhe bisedonin pa ndjenjën e pranisë së Komandantit. Më dukej e habitshme sesi në tërë ato orë unë nuk pashë asnjë nga familja e tij të afrohej, siç ndodh rëndom në tërë familjet, ku të vdekurit e tyre duken sikur kanë më shumë vlerë, edhe pse pa frymë në shtat. Nuk arrija dot të besoja se kisha të shtrirë përpara meje një nga njerëzit më të rëndësishëm në historinë e kombit, atë subjekt historik, që do të mbahej patjetër mend për gjithë ç'pat bërë në ato pesëdhjetë vjet.

Por jo. Ai nuk ish Komandanti. Komandanti nuk ishte aty. Aty ishte vetëm një kufomë e boshatisur, një objekt pune. Pjesë të organeve të tij ishin hequr tej. Njerëz, para meje, patën punuar mbi të dhe vazhdonin të punonin, që ai të merrte edhe një herë, për herë të fundit, formën dhe pamjen e rëndë madhore, atë që jetonte në përfytyrimin e milionave vetëve. Pra, Komandanti dukej se qe i çmontuar, i shpërbërë, i hapërdarë, ca nën çarçaf, ca në ato pjesët që kirurgët dhe ai njeriu me sytë e lidhur i ndanë nga trupi, ca

në zyrën e Kryesisë, ca në mjediset e familjes, ku duhet të kish pikëllim gjithsesi.

Tani nuk kisha më drojën ta prekja kufomën. U mësova me ftohtësinë e tepruar që kanë zakonisht mishrat pa jetë. Duhej gjetur një zgjidhje për shtrimin mbi fytyrë të toneve të zakonshme që kanë nevojë për ngrohtësinë e trupit. Ia kisha frikën drunjëzimit që do të kishim ditë pas dite. Kur pat vdekur, vallë? Atë ditë, apo, ndofta, kishte ndodhur më shumë sesa një ditë e dy?!

U zemërova me veten time për këtë pyetje boshe dhe kujtova vetëm zotimin që i bëra Telos.

Të fshehtën do ta mbaja.

Në shtëpi po kthehesha i trajtuar tërësisht ndryshe nga mënyra se si më patën marrë. Askush nuk fliste, po të mos flisja unë. Unë thashë diçka për kohën dhe fola për koncertin që po përgatitej në sheshin para universitetit. Biondi tha se, atje, qe ndërtuar një tribunëz e vogël portative.

Tribunëza ia shpuri secilit nga ne mendjen te qëllimi për të cilin ajo qe ngritur, por asnjëri nuk zuri në gojë atë, që qarkullonte prej ditësh, praninë e udhëheqësve në koncertin e të rinjve. Kishte shumë të ngjarë, që porosia për tribunëzën ishte dhënë para se Komandanti të ndërronte jetë dhe pastaj nuk e kishin rikthyer urdhrin për tribunëzën e posaçme për të. Punë e madhe, se do të shkonte kot puna dhe materiali për atë palo ngrehinë të përkohshme! Nëse lajmi i kobshëm do të jepej në darkë, atëherë gjithë përgatitjet e koncertit do të kishin qenë të kota. Koncerti do të ishte kurbani i parë në vargun e masave për zinë kombëtare. Pastaj vinte dasma e Florës e kështu me radhë.

Por zia kombëtare nuk u zu në gojë në bordin e makinës sonë me xhama të errët. Të vërtetën tronditëse e dinim unë dhe Skënderi. Vetëm për këtë isha i sigurt. Isha kureshtar të dija, për shembull, a kishte dijeni shoferi që Komandanti pat ndërruar jetë? Ma donte mendja, jo. Sa për dy të tjerët, ata që vinin me Skënderin, isha tërësisht i bindur që ata nuk dinin gjë.

Makina më la dyqind metra pa arritur te banesa. Ishte orë e vonë dhe vendi ku zbrita ishte i tëri në errësirë.

“Nesër më shtatë e gjysmë! Këtu!” thashë një si gjysmëlutje e gjysmurdhri, para se të shtyja derën.

“Si urdhëron!” ma ktheu Skënderi që, me sa dukej, nuk e kish fare të vështirë, që brenda pak orësh, të kërcente nga roli i urdhëruesit, në atë të të bindurit kokunjur.

Ditin e pat zënë gjumi, kurse Xhulja ishte në ankth. Ajo më pat pritur duke ndjekur një program komikësh në ekranin e Televizionit Shtetëror. Nuk e dija se çfarë i pat shpjeguar asaj drejtori im, por dukej që ai nuk kish qenë aq i zoti, sa të ma qetësonte gruan. Unë nuk i thashë asaj asnjë fjalë, por e shtrëngova gjatë në krahët e mi duke e puthur me mall, sikur po kthehesha nga një udhëtim i largët dhe i vështirë. E puthja në buzë, në sy, në hundë, në mollëzat e bukura dhe e uroja pa pushim për jubileun e martesës sonë.

Të puthurat e qetësuan disi nusen time, por e tërë pamja e saj ishte pyetëse.

“Do të flasim”, i thashë, “por lërmë të puth edhe djalin më parë.”

Ajo më ndoqi pas, deri te krevati i djalit, gjithmonë në pritje të shpjegimeve të mia. Djali kishte një pamje të qetë

dhe gjumi i tij i lehtë më prehu. Unë bëra vend dhe u ula në një cep të krevatit, kurse Xhulja u rehatua në prehrin tim.

“Të vjen keq që nuk e bëmë festën?” e pyeta. “Sa shumë po e prisnim, ëh!”

“Po ne mund ta bëjmë tani”, ma ktheu ajo. “Dhe Ditin e zgjojmë. E nesër ia lejojmë vetes të vemë pak me vonesë nëpër punëra. Këtu çdo gjë është gati. Supën e kam mbajtur të ngrohtë, kurse mishin...”

“Jo, Xhulja, nuk mundem. Nuk më hahet.”

Ajo u merakos përsëri.

“Si është puna, Bet? Pse nuk më thua çfarë ka ndodhur?”

Unë e putha përsëri dhe ia thashë:

“Ka vdekur Komandanti.”

“Çfaaaaaaaarë?!!!!!!!”

U pendova menjëherë që ia tregova. Ajo klithi, aq fort, sa djali u zgjua i trembur. Mund të mos ia kisha treguar. Unë mund ta shtyja lajmin me ca shpjegime të besueshme dhe të mos e bëja time shoqe të klithte aq shumë, sa të më bëhej se “çfarë”-a e saj kish arritur deri në veshët e njeriut me mustaqe. Nganjëherë ne rrëfejmë ca të fshehta të ndaluara vetëm për të rixhiruar edhe një herë filmin e bukur, atë me fytyrat tona, kur vetë ne i patëm marrë vesh papritur ato. Por Xhulja ishte femër dhe unë duhet ta parashikoja efektin e atij lajmi të madh mbi të. Unë tani do ta bindja me orë të tëra që kjo ishte një e fshehtë përvëluese, që ajo nuk duhet t’ia tregonte askujt, sidomos mamasë së saj llafazane.

U pendova, u pendova vërtet që ia thashë. Kërcënimi i Telos tani nisi të më dukej edhe më i kobshëm. Fillova të përkëdhelja Ditin, që ish ende i tronditur nga klithma e llahtarshme e mamit të tij dhe t’i jepja shpjegim Xhuljas për

tërë pyetjet e saj, nga të cilat mësoi përse më kishin thirrur, mënyrën se si erdhën dhe më morën, kur do të mund të jepej lajmi zyrtar, çfarë pamje kishte tani Komandanti i vdekur dhe një mijë pyetje të tjera, që ngjanin sikur shtynin me bërë njëra-tjetrën për të dalë kush e kush më parë nga ajo gojëza e bukur e gruas sime.

U përgjigja sa munda dhe iu luta të largohej, sa t'i tregoja djalit një përrallë që ta zinte gjumi përsëri. I premtova se do t'ia vazhdoja rrëfimin fill e për pe, më pas.

“Po më beso”, i thashë, “kam firmosur me rrezik koke për të gjithë ne. Askush nuk duhet ta marrë vesh këtë. Se as gratë e djemve të Komandantit nuk e dinë. As anëtarët e Byrosë Politike. E dinë, a nuk e dinë, nja shtatë vetë gjithsej!”

“Po, a është e vërtetë që ti e pe atë? Ta treguan të vdekur?”

“E pashë me këta sy dhe e preka me këto duar.”

Ajo drithëroi në këtë përfytyrim dhe u largua në kuzhinë duke ia bërë “ua-ua- ua!” Unë iu ktheva djalit e ndërsa fillova përrallën, ndieja ende Xhuljan, që andej matanë, fliste me vete: “Ua- ua! E pabesueshme!”.

Djali nisi të dremiste nën efektin nanuritës të përrallës, kur Xhulja u dha tek ne me tërsëllëmë.

“Po ti, gënjeshtër më tregon mua?! Gjete temë të bukur për t'u tallur!”

Unë po e vështroja i habitur.

“Hajde të shikosh!” ma bëri ajo dhe gati më tërhoqi zvarrë.

Televizioni kish emisionin e lajmeve dhe në kronikën e ditës po jepte pritjen, që Komandanti, pat dhënë atë pasdite për nder të kryetarit të partisë marksiste-leniniste të Brazilit.

Unë mbeta si i goditur. Nuk po e kuptoja isha në ëndërr tani, apo kisha qenë në ëndërr tërë ato orë që kalova pranë të vdekurit. Komandanti dukej i hequr, fytyra e tij shfaqej mjaft e tretur, megjithëse jo aq sa ishte para një ore, kur unë e prekja me gishta duke bërë plane të merresha me të. Ishte një efekt i çuditshëm, si një shaka e egër. Dukej sikur ai pat pritur sa të zhdukeshin unë nga porta e sallës së nëndheshme, pat palosur çarçafin e lagur dhe në majë të gishtave kishte nxituar të përgatiste pritjen e brazilianit.

Një ndjenjë e çuditshme, kjo. Isha si i çakërdisur nga ajo që po shihja.

Unë nuk po ia hiqja sytë kronikës, teksa e ndieja që Xhulja e mbante vëmendjen të ndarë, sa në ekran, aq në fytyrën time të hutuar dhe vazhdonte të më kërkonte shpjegimin. Unë e pikasa menjëherë, se ajo që po shfaqej në ekran ishte pjesë e një kronike të vjetër, e bërë më parë, por jo shumë larg nga dita e sotme. Duhet të ishte zgjedhur posaçërisht për t'u dhënë sonte. Dhe, rastësisht, ato ditë edhe personaliteti nga Brazili ndodhej për takime pune në Tiranë. Nuk isha i sigurt, nëse ai që ftuar posaçërisht për të bërë këtë shfaqje, apo vizita e tij këto ditë ishte krejt rastësi. Ama, isha i sigurt, që filmimi i bërë më parë, që ruajtur me kujdes pa u shfaqur, duke u ndier i nevojshëm për një ditë si kjo.

Ajo që më intrigoj më shumë ishte njoftimi që bëri folësi kryesor i lajmeve, se të nesërmen, miku brazilian kishte në plan të vizitonte ekspozitën me arritjet e socializmit në vendin tonë dhe në fund të pritjes, Komandanti i pat premtuar, se do të linte çdo punë dhe do t'i shërbente si ciceron ekspozite kryetarit të marksist-leninistëve të Brazilit.



“Dhe nuk besoj se do të gjesh ciceron më të mirë për arritjet tona, bëri shaka shoku Komandant!” e përfundoi lajmin me një buzëqeshje të lehtë folësi i televizionit.

Ai që mbylli lajmet e fundit nuk harroi të përsëriste, se të nesërmen teleshikuesit do të ndiqnin një kronikë të zgjeruar nga endja në ekspozitë.

“Gënjeshtër më të trashë në ditën e shënuar të martesës, nuk besoj se i ka dhuruar ndonjëri gruas së vet”, tha Xhulja duke mbyllur televizorin me grusht e vajti u mbyll në dhomën e gjumit me lot në sy.

E ndoqa për ta qetësuar dhe për t’i dhënë logjikën e mundshme të shpjegimeve. Po nuk donte më shpjegime Xhulja. Unë u përpoqa disa herë ta shtroja të dëgjonte, por ajo nuk bindej. Aq sa më në fund e humba durimin dhe iu shkrella:

“Kuaq të pazotin më di ti mua, moj nusja ime?! A mund të jetë gënjeshtër një lajm, që nuk do të ketë jetë të gjatë, pasi në orët që vijnë do të provohet menjëherë? Po të kisha ndonjë hile në ditën e festës sonë, a nuk mund të gjeja unë njëzet gënjeshtër, që për t’u zbuluar do të ishin më të vështira, shumë më të vështira se kjo?”

“Atëherë përse zgjedhe këtë?” pyeste ajo me fytyrën qull nga lotët.

“Sepse është e vërtetë, shpirte!” pëshpërisja me forcë unë.

“Që ai ka vdekur?”

“Po, që ai ka vdekur!”

“Dhe ti e ke parë me ata sy dhe e ke prekur me ato duar?”

Xhulja nuk i kish marrë nga unë të gjitha faktet dhe mënyrën se si aty lart kishin vendosur ta fshihnin gjëmën, për të mos dekurajuar, nuk di se kë, a për të mos lumturuar, nuk di se kë tjetër. Kjo ishte në harmoni të plotë me kërkesën këmbëngulëse, që më patën bërë mua dhe me disiplinën e fshehtësisë, që po vendosnin Teloja, bashkëshortja dhe Kryesia. Ata e dinin se, sado me forcë ta kërkonin mbajtjen e sekretit, ai ishte një sekret që ka vlerë magjepsëse, kur ende nuk është thënë publikisht. Por ish e pamundur që ai të mos qe përhapur, siç e përcolla unë te njeriun im më i afërm, Xhulja. Dhe për teleshikuesit si Xhulja, loja që bëhej me kronikat ishte e përsosur dhe jepte efektin e dëshiruar.

U zhvesha dhe nën mbulesat u mundova ta qetësoj time shoqe duke ia shpjeguar të gjitha këto. Deri në njëfarë shkalle arrita të bëhem bindës, por jo tërësisht, pasi kur ajo filloi të më përkëdhelte dhe të kërkonte një përgjigje më të zjarrtë, unë ndihesha i boshatisur. Mollëzat e gishtërinjve të mi ende ishin të ftohtë nga gjithë ajo akullimë që më kish transmetuar fytyra e të vdekurit dhe lëkura e dashur e gruas sime nuk m'i ngrohte dot. Unë isha i zbrazur. Bosh. Më dukej sikur njeriu me sy të lidhur, që pat nderuar me grusht, më kish hequr edhe mua të brendshmet.

Xhulja ime kish akoma dyshime mbi vërtetësinë e aventurës që i tregova. Tërë natën e ndjemë njëri-tjetrin të zgjuar, por nuk shkëmbyem asnjë fjalë.

Gjatë natës trupin e Komandantit e kishin zhvendosur në zyrën që i patën marrë nënkryetarit të Parlamentit dhe që specialistët patën arritur ta shndërrojnë në frigorifer.

Provat me parametrat e frigoriferit kishin dalë mjaft mirë dhe në orën tre e dhjetë të mëngjesit, prijësi i vdekur qenkësh vendosur atje. Këto m'i tha nën zë Skënderi, kur erdhi të më merrte me grupin shoqërues, kështu që makina jonë iu drejtua presidencës. Para zyrës frigorifer bënin roje dy ushtarë të gardës, që të dy me koka të qethura dhe me kostume të njëjta civile, që njerëzve nga fshatrat e thellë nuk u rrinë kurrë si duhet. Valixhen time e gjeta në dhomën ngjitur. Ishte sajuar aty një shtrat i mirë dhe frigoriferi që mbushur me ushqime e lëngje të freskëta.

“Në ditët që do të ekspozohet trupi për vizitorët”, më sqaroi Skënderi, “është menduar, që ju do të rrini më shumë këtu, se në shtëpinë tuaj. Sidoqoftë, ata orarin ua kanë lënë juve në dorë.”

Teloja e mbajti fjalën. Aparati fotografik ishte nga më të mirët e atyre kohërave në vendet e Perëndimit. Dhe atë ma sollën tok me një numër dritash, që të kisha mundësi të bëja kërkime me ndriçimin.

Dy versionet e fotove që përgatita nuk kishin shumë dallim nga njëri-tjetri. Sheshimi i thellukave nga tretja ishte i njëjtë. Ndryshimi ishte vetëm te shprehja e buzëve. Unë do të preferoja atë më solemnin, por vejusha paskësh pëlqyer atë më të çelurin. I kisha lënë një buzagaz të lehtë, të ç'tensionuar që përhapte njëllë ngrohtësie. Natyrisht, do të fitonte versioni që pëlqente e shoqja, prandaj unë nuk u shtyva më në kërkimet e mia.

Vejusha pat kërkuar të më takonte dhe Teloja më shpuri tek ajo, aty afër drekës.

Ajo ish e veshur me një kostum të zi, qe ulur në një dhomë pritjeje të thjeshtë dhe ishte përqendruar mbi një ekran, ku shfaqeshin ceremonitë mortore të marëshallit Tito dhe pasqyroheshin nderimet që i bënin vizitorët udhëheqësit të vdekur jugosllav. Mbi një raft ishte një portret i Komandantit, cepin e të cilit e priste një shirit i zi.

Sapo na vuri re, gruaja i ktheu kurrizin ekranit, ku kuadrot mortore vazhduan të shfaqen pa ndalim gjatë gjithë pranisë sonë atje.

Portreti me shiritin e zi më bëri ta ndieja veten më të lirë dhe unë i shpreha ngushëllimet shoqes të Komandantit të vdekur.

“Ngushëllimet e mia më të sinqerta!” i thashë.

“Faleminderit, mor djalë”, ma ktheu ajo. “Në tërë Shqipërinë, ky është i vetmi kënd, ku vdekja e Komandantit është shpallur tashmë dhe ku nuk u bindemi masave të fshehtësisë që na kanë vendosur shokët e udhëheqjes.

Unë të falënderoj për ngushëllimin, por sidomos për punën e mirë që po bën.”

Pastaj ajo mori fotografitë që i pata dërguar më parë me Telon dhe ma shfaqti pa lëkundje parapëlqimin e saj:

“Kjo me buzën lehtësisht në gaz, më pëlqen më shumë”, tha ajo duke më zgjatur njërën nga fotografitë. “Por a do të jesh vallë në gjendje ta arrish çdo ditë këtë? Se do të jenë shtatë ditë ato, kur trupi do të vendoset mëngjes e mbasdite, për të marrë lamtumirën e veteranëve të luftës, të masave punonjëse, kooperativistëve, ushtarakëve, të rinjve, të rejave dhe pionierëve. Dhe kamerat do të jenë mbi të dhe nuk mund ta pranojmë që ai të mos ketë të njëjtën shprehje, nga seanca në seancë.”

“Mos u shqetësoni”, i thashë. “Ne do të kemi vetëm një fotografi udhëzuese, të cilën do ta zbatojmë me besnikëri.”

Pastaj ajo më kërkoi që të isha vazhdimisht i pranishëm, kur të parashiheshin kontaktet e vajtuesve me të vdekurin. Më tha se andej nga jugu, gra të moshuara që ruajnë traditat e vajtimit, me shumë gjasa, do të afroheshin ta qanin me ligje udhëheqësin e shtrenjtë. E ajo mendonte se gratë nuk duheshin penguar ta derdhnin vajin e tyre, siç i kanë zakonet. Ajo ishte gati e sigurt që do të kishte Heronj të Punës Socialiste, ushtarakë, të rinj e veteranë, që do të donin ta preknin, ta puthnin e ta përqaфонin.

“Ne nuk do të frenojmë shpërthimin e pikëllimit, apo jo, Telo?” iu drejtua ajo njeriut të pushtetshëm që kujdesej për përgatitjet.

“Ashtu është, si urdhëron”, ia bëri ai. “Shoku Betim ma ka bërë të ditur shqetësimin e tij dhe unë garantoj që çdo gjë do të vejë mbarë.”

Vejushës i tërhoqi vëmendjen një teknik që diç kërkonte t’i thoshte.

“Ç’është atje?” pyeti ajo.

Dhe sapo vuri re se tekniku druhej nga unë ia dha lejën që ai të fliste pa merak.

“Në ekranin tjetër, keni gati filmimet për homazhet dhe pikëllimin e qytetarëve sovjetikë për Stalinin.”

“Por m’i ndaloni këto me Titon, atëherë!” ia priti e zonja e shtëpisë. “Se nuk i shoh dot të dy njëherësh!”

Tekniku u kthye pas mbi gjurmët e tij, por ndaloi sakaq pasi bashkëshortja e Komandantit kishte akoma vërejtje.

“Pastaj, përse m’i sillni mua?!” tha gruaja. “Janë ata shokët e protokollit që përgatiten. Apo jo? Shpjeruani atyre!”

Tekniku mblodhi supet pa ditur ç'të bënte.

“Filmimet me Stalinin janë bardhezi?” pyeti aty për aty zonja e shtëpisë.

“Si urdhëron. Bardhezi!” dhe tekniku nisi të shpjegojë me një zë të butë që i përshtatej përsosmërisht atmosferës mortore: “Ne kemi tri kopje. Njërën po e shohin shokët e protokollit, tjetrën Kryesia e Byrosë Politike dhe një e përgatitëm për ju.”

Gruaja e dha pëlqimin.

“Mirë. Lëshojeni ta shikoj dhe unë!”

Dhe ndërsa tekniku po dilte ajo u vërtit përsëri nga ne e nisi të na shpjegojë: “Edhe pse bardhezi, ato pamje janë shumë më të vërteta. Këta jugosllavët janë të tharë nga ndjenjat. Rusët me siguri do të jenë më pasionantë. Do t’u kërkoj shokëve të udhëheqjes të ndiqet forma e funeralit të Stalinit, por megjithatë, jo përmbajtja! Përmbajtjet nuk mund të kenë të krahasuar. Shoku Komandant është i paarritshëm e nuk i gjen dot të dytë në dashurinë që gëzonte në popull. Pikëllimi i popullit tonë për udhëheqësin do të jetë më i madh dhe do të lërë një vazhdë të gjatë. Dhe ju duhet ta shikoni mirë dhe me shumë përgjegjësi që shfaqja e këtij pikëllimi të mos pengohet as edhe një çikë! Mbaruam, atëherë. Ju faleminderit!”

Ndërsa ne po ngriheshim të iknim, pamjet e arkivolit të Titos në ekran u zëvendësuan menjëherë me një filmim të vjetruar. Tani në katrorin e televizorit shquhej Stalini i shtrirë në një tjetër arkivol, rrethuar nga anëtarët e Byrosë Politike të asaj kohe. Ata kishin ca fytyra të ngjallme jashtë mase, që dukeshin sikur e kishin veshur me shumë mundim pikëllimin që u nevojitej.

Pata përshtypjen se Vejusha nuk e dëgjoji përshendetjen tonë të largimit. Ajo qe rrëmbyer e tëra nga pamjet e vjetra të Kremlinit.

Ne dolëm tok me Telon dhe duke u çapitur ngadalë, u drejtuam nga presidenca e Parlamentit. I thashë Telos se liria që kërkonte t'u linte bashkëshortja e të ndjerit vizitorëve, rrezikonte punën time.

“Unë jam me ty”, më tha Teloja. “Po aty nuk mund t’i dilja kundër asaj. Do të bëhet ashtu si dëshiron ti. Ki besim tek unë!”

Gjatë rrugës, në parkun ende të pagjelbëruar mirë, dikush e kërkoi Telon në radio. Ai dëgjoji me respekt atë që i fliste dhe pastaj iu përgjigj atij:

“Po, po! Ja, sapo më thirri shoku Komandant dhe më tha se ai do të asistojë në koncertin rinor që bëhet sot para universitetit. Hëpërhë, ky është plani, por unë ia kam frikën, a do të zbatohet pikë për pikë, ngaqë..” dhe këtu Teloja e uli zërin edhe më tej: “... ngaqë Komandanti nuk e ndiente fort mirë veten sot.”.

Teloja mbylli radion dhe eci një copë rrugë pa folur. Ai nuk kish nevojë që të më shihte në fytyrë, që të ndiente, se unë e desha një shpjegim për ato fjalë që sapo shqiptoi.

“Komunikimi zyrtar i vdekjes do të jepet nesër”, tha ftohtë. “Do të thuhet, se shoku Komandant mbylli sytë në të gdhirë.”

Unë nuk kisha asgjë për të thënë. Ecja pa fjalë përbri tij.

“Koncerti i rinisë do të fillojë në ora shtatë e gjysmë”, tha pas pak Teloja.

“Dhe shoku Komandant do të marrë pjesë në të?” e pyeta unë, sikur të ishim në një ditë të zakonshme, të para njëzet e ca vjetëve.

Ai e mbajti çapin dhe më vështroi me vëmendje. M’u duk se i pat pëlqyer se si e formulova pyetjen time, prandaj përgjigjen ma dha njësoj, si t’ia jepte një shoku të sektit të tij.

“Po. Por nuk do të rrijë deri në fund.”

“Për këtë do të lipset ndihma ime, me siguri!” e mora me mend unë.

Telos po i pëlqente gjithnjë e më tepër nuhatja ime. Po kuptoheshim mirë me njëri-tjetrin.

“Do të lipset, posi!” m’u përgjigj.

“E ku është ai, ... tjetri, që... do të përdoret?”

Teloja pa orën.

“Duhet ta kenë sjellë. Në këto momente, duhet të jetë në dhomën që është caktuar për ty.”

Pra, ishte fjala për një sozi, për një njeri-kopje, që do të dublonte Komandantin. M’u përshkëndit fantazia. Kisha dëgjuar që njerëz të tillë, të ngjashëm deri në hutë, përdoren shpesh për të zëvendësuar mbretër dhe perandorë, por sot, për herë të parë, do të shikoja një të tillë, i cili do të jepte përfytyrimin e udhëheqësit të një vendi, që lufton i vetëm për fitoren e klasës punëtore në të gjithë vendet e botës. Kuptohet se, një njeri i tillë mund të gjendet kollaj në Kinë, apo në Brazil, që janë vende me qindra milionë dhe, bile, miliarda banorë, por që Teloja të kishte arritur të gjente një shëmbëlltysë të ngjashme, si kopje të Komandantit, në një vend të vogël me as tri milionë frymë, kjo meritonte vërtet brohoritjet e Kryesisë të Byrosë Politike.



Njeriu ishte vërtet atje, në dhomën time. E kishin sjellë dhe ai po na priste. Ne e gjetëm në këmbë, ngaqë, si dukej, ai qe ngritur sapo dëgjoi zhurmën që bëri çelësi im, tek hapja portën. Nuk na përshëndeti dhe as ne nuk e përshëndetëm. Rrinte si më gjemba, mjaft i trembur duke pritur një urdhër a një qortim nga Teloja, të cilit, me sa vura re, i trembej shumë.

Kishte shtatin e atij, për të cilin qe zgjedhur ta dublonte. Dhe sidomos i ngjante shumë, jashtëzakonisht shumë. Dukej e gjitha si një situatë surreale. Dhe surreale e bënte më shumë fakti, që shëmbëlltyra e atij njeriu që kisha përpara ndodhej i vdekur disa metra më tej, në dhomën përbri.

Dhe ne, te ky, e shihnim përsëri të gjallë.

Teloja kuptohej që ish mësuar dhe herë të tjera me këtë dyzim, kurse mua po më merrej mendja nga e gjithë kjo situatë groteske. Turbullira qëndronte në atë, që ky njeri, që e kishim përpara ngjante si ai, kryekëput si ai e megjithatë shfaqte një dobësi, që atij tjetrit nuk ia përfytyroja dot kurrsesi: dridhej i tëri nga frika, pa ia shqitur për asnjë grimëherë sytë njeriut që e pat thirrur aty.

Teloja dukej i zemëruar. Po e këqyrte me vërejtje kopjen e Komandantit nga koka te këmbët. Vuri duart mbi mustaqe dhe iu shkreh ashpër:

“Nuk i ke zbatuar porositë që të kemi dhënë! Je ushqyer si derr! Sikur ke futur turinjtë në grazhd. Ke vënë bark. Shiko!”

“Jo, ju betohem”, i përgjerohej tjetri. “Për jetën e dy vajzave! Kjo më ka ndodhur ngaqë rri gjithmonë mbyllur dhe nuk lëviz. Unë jam tërë kohën i uritur. Ju betohem”, i përsëriste Telos, duke e ndjekur pas, teksa ai shkonte drejt frigoriferit.

Telos nuk po i dilte inati. Hapi, duke e përplasur, derën e frigoriferit, nxori që atje, një shishe plastike dhe e mbylli derën, me një përplasje të dytë.

“Hajt’ se di unë, se si të të ushqej ty, këtej e tutje!” ia bëri eprori.

Dhe duke e goditur shëmbëlltyrën e Komandantit, në bark, me kokën e shishes që nuk e pat hapur ende, vazhdoi: “Mullë prej të urituri është kjo?!”.

Telos nuk i doli aspak inati, sa kohë qëndroi aty. Ashtu, i inatosur, na i la edhe porositë. Më kujtoi mua se e donte këtë dublantin me një zbehtësi fytyre, që t’i shkonte një njeriu të lodhur nga ngarkesa e ditës.

E kuptova që puna ime duhej të ishte në harmoni me faktin, që udhëheqësi i partisë, befas nuk do të ndihej mirë dhe, për atë shkak, do ta braktiste në mes koncertin e të rinjve.

“Ti e kupton, se si e kërkojmë sot”, ia bënte duke parë me ngulm në fytyrë burrin që dridhej. “Do ta donim më të tretur, por këta lloj viçash, si ky, të lënë në baltë.”

“Ju betohem për nder, sho...”

“Lëre nderin!” i uluriti Teloja. “Të dëgjova. Tani je në duart e këtij shokut. Dhe bëj si të thotë ky. E kupton urdhrin?”

“Si urdhëron!” përgjigjej shëmbëlltyra e Komandantit në çdo porosi të Telos. “Si urdhëron! Por... shokun nuk e njoh. Ky nuk ka punuar ndonjëherë me mua.”

“E dimë”, ia priti tjetri duke u nisur drejt derës. “Bëj si të thotë ky. Do të takohemi edhe një herë në vilë, përpara se të nisesh për në shesh, kur të jesh në krye të personaliteteve të larta shtetërore.”

“Si urdhëron, sho...!”

Mua nuk m’u duk me vend që të filloja nga puna që atë cast. Duke pasur parasysh fillimin e koncertit, besoja se më mjaftonte një seancë njëorëshe, aty rreth gjashtës.

Teloja nuk pati kundërshtim. Me gishtat mbi dorezën e derës, i tha dublantit që të mos lëvizte nga dhoma dhe ia bëri të ditur se menjëherë do të urdhëronte të mos i sillnin drekë. Dublanti nuk foli. Nuk tha, “si urdhëron”, siç thoshte për të gjitha, dhe mua m’u duk se ky ndëshkim do të qenkej i rëndë për të.

Para se të kthehesha në shtëpi, unë kalova edhe njëherë në dhomën e shndërruar në frigorifer. Aty ishte ftohtë dhe kufoma m’u duk në gjendje të mirë. Çapajevi i kish pasur parasysh edhe kërkesat e mia dhe qe kujdesur mjaft për mirëmbajtjen. Kishin sjellë arkivolin dhe lulet që do të viheshin në të. Parfimet që do të përdoreshin ishin francezë, nga markat më të fisme. Edhe dy kostumet që pata kërkuar m’i kishin sjellë. M’u dukën shumë të gjerë për atë fizik të mpakur dhe e ndieja që më duhej të bëja dhe përshtatjen e tyre me trupin. Isha i sigurt, që të nesërmen, në ditën e njoftimit, nuk do të fillonin menjëherë homazhet dhe Komandanti nuk do të shihej nga vizitorët e përzishëm, të paktën, nuk do të shihej nga një publik i gjerë. Teloja më bëri me dije se një provë me pamjen brenda arkivolit nevojitej për ata të Kryesisë.

Skënderi më tha se makina e ndezur po më priste mua nga pjesa e pasme e ndërtesës. Tërhoqa derën dhe prita shoqëruesin që po e mbyllte duke rrotulluar kyçin në bravë.

Aty na u afrua një nga femrat që punonte në zyrat përreth dhe njoftoi Skënderin se e kërkonte për pak çaste shoku

Kristo, nënkryetari i Parlamentit. Ajo na bëri me dije se ishte sekretarja e tij.

“Më kërkon mua?!” u habit shoqëruesi im. “Unë nuk kam ndonjë punë me shokun Kristo”, i tha ai sekretares pa shumë mirësjellje.

Nënkryetari në shoqërinë e një nëpunësi tjetër ishte vërtet nja njëzet hapa më tej dhe po e ndiente kundërshtimin e Skënderit. Ky vështroi nga unë dhe psherëtiu me bezdi.

“Veç një minutë!” e nxiti më tej gruaja. “E shikoni? Ai po ju pret.”

“Duhet ta ketë gabim, moj shoqe!”

“Edhe mund ta ketë”, nuk e përjashtoi sekretarja. “Ju, ejani! Ai është anëtar i Byrosë Politike!” e ftoi edhe njëherë ajo si me të lutur, duke kafshuar buzën e poshtme me njëfarë qortimi miqësor.

Skënderi shfryu edhe një herë, m’u lut mua të prisja dhe u nis pas sekretares. Iu afrua nënkryetarit dhe e përshëndeti me një respekt të shtirur.

Unë isha larg dhe munda ta shquaja dialogun e tyre vetëm kur në korridor kish qetësi të plotë, gjë që ndodhi vetëm dy-tri herë. Shoku Kristo i murtryer në fytyrë e pyeti se me se merrej dhe nga shenjat që bënte për nga salla, ku ne kishim vendosur trupin e të vdekurit desh shpjegime që ai me sa dukej nuk i kishte marrë dot gjetiu. Binte në sy qartë pozita e tij e pavolitshme dhe aspak e përshtatshme për rangun e tij. Këtë pa dyshim e ndiente dhe Skënderi, i cili dukej që po e përmbante më me zor arrogancën e tij të natyrshme.

“Cili je ti, mor bir? Ç’punë bën?” dëgjova tek pyeste nënkryetari. Dhe meqë Skënderi nuk i përgjigjej, pyetja iu përsërit. “Cili je, po të pyes!”

Unë nuk arrita ta dëgjoj përgjigjen e Skënderit, por ai duhet t'i kish dhënë një të tillë, që nuk e kënaqi anëtarin e Byrosë.

“Ore, të mos i biem rrotull e rrotull. Të kanë parë që hyn e del në atë që deri dje ishte zyra ime. Çfarë ka ndodhur? Kush je ti? Çfarë po bëni atje brenda?”

“Unë kam jashtëzakonisht respekt për ju, shoku Nënkrjetar i Parlamentit. Por...”

Fjalët e tjera të Skënderit nuk po i dëgjoja më, por kjo nuk qe dhe aq e nevojshme, se shoku Kristo ia preu ato në mes:

“Leri, more, tjerret! E m'u përgjigj pyetkës!”

“Nuk jam unë ai që duhet t'jua bëj këtë sqarim, shoku Kristo”, ia ktheu pa shumë ceremoni e me zë më të lartë se më parë shoqëruesi im, duke i kthyer krahët dhe duke ardhur drejt meje. “Me lejën tuaj, po largohem”, e njoftoi kur tashmë ndodhej më afër meje, sesa më afër anëtarit të Byrosë Politike.

“Je arrogant edhe i pacipë!” i bërtiti ai i xhindosur që pas. “Do të pendohesh për këtë sjellje harbute.”

Por shoqëruesi im ishte i sigurt që nuk do të pendohej kurrë. Pa bërë asnjë koment e pa më treguar asgjë nga dialogu që më kish shpëtuar, ai u bashkua me mua në rrugën drejt makinës që po na priste.

Rrugës për në shtëpi na ndodhi një e papritur, që ma shpuri mendjen te konflikti me time shoqe, një natë më parë.

Tek zbrisnin përgjatë lumit për të dalë në pjesën perëndimore të unazës të kryeqytetit, te godina e fundit e bërë nga arkitektët italianë, na ishte bllokuar rruga. Nuk

ishin vetëm policët e trafikut rrugor, por dhe ushtarë të gardës, që urdhëronin me arrogancë ndryshimin e lëvizjes, duke penguar autobusët urbanë dhe të gjitha makinat e tjera, të vogla e të mëdha, që të vazhdonin rrugën bri ekspozitës që përmbante arritjet e erës së socializmit. Shoferi ynë, që nuk e kish vështirë të çelte rrugën, që të shpinte në banesat e udhëheqjes, këtu, hoqi të zitë e ullirit që të merrej vesh me ata që e kishin bllokuar. Unë dhe Skënderi – këtë radhë nuk i kishim me vete dy të tjerët, – pamë nga xhami i përparshëm, se si shoferi ynë grindej me një oficer, që mbante një radio në dorë dhe që nuk desh të hante pykë kurrsesi, por i zgjaste dorën nga duhej të drejtoheshin të gjitha makinat pa asnjë përjashtim.

Shoferi u kthye në timon i nevrikosur.

“Hajde merru vesh me atë që e ka kokën gdhë!” tha duke shfryrë.

“Lejoi vetëm një makinë të televizionit. Thonë që po viziton ekspozitën një delegacion i madh brazilian. Phë! Brazilian!” vazhdonte duke shfryrë me ndjenjën e njeriut që është poshtëruar. “Edson Arantes, ose Pele!” shqiptoi për t’u engledisur të vetmin emër brazilian që pat dëgjuar në jetë.

E shpuri automjetin nga ai drejtim që e urdhëroi oficeri, por akoma shfrynte kundër tij.

“Or, po, nuk po e çan njeri kokën për brazilianët, por thonë që ata i shoqëron Komandanti, prandaj janë ngritur më këmbë të gjithë sot.”

Skënderi dhe unë nuk pipëtimë.

“Bet i dashur”, i thashë vetes, “e more përgjigjen e pyetjes sate këmbëngulëse, nëse e di, apo jo, shoferi që ke përbri, se ç’punë po bën këto ditë pasagjeri i çmuar, që ai e shpie dhe e sjell nga shtëpia, ose më mirë, e shpie dhe e merr diku afër shtëpisë!”

Do të më duhej të grindesha ende edhe disa orë të tjera me Xhuljan që për të më nxjerrë mua gënjeshtar do të nxitonte të shihte kronikën e premtuar nga televizioni për vizitën e miqve të shquar në ekspozitën e fitoreve të socializmit dhe do të shihte se si udhëheqësi ynë i nderonte, duke bërë për ta, ciceronin.

Dhe televizioni e pat transmetuar kronikën e vizitës me shoqërimin e jashtëzakonshëm që u bëri miqve i pari i vendit. Por unë nuk e pashë dot, se, në atë kohë, isha afër disa zhvillimeve të tjera.

“Përse vallë kaq hollësira dhe inskenime”, mendoja në atë copë rrugë, që më ndante nga shtëpia ime. Kush ishte ai që duhej të mashtrohej? Çfarë lloj forcash civile dhe ushtarake mund të kishte ende në dorë ai, Njeriu i Keq, të cilin po përpiqeshim ta linim ende në gjumë dhe të mos i tregonim se Komandanti vdiq dhe rruga për atë, të Keqin, qe hapur? Ato dy- tri net me liderin e vdekur e të përgatitur për lamtumirë, kryeqytetit, po mundoheshin t’i jepnin një pamje moskokëçarëse, gazmore, gati-gati të lumtur. Por, a kish qenë e mjaftë koha për të marrë gjithë ato masa të sigurisë? A janë marrë ato gjer në kohën e koncertit, kur themeluesi i partisë do të lërë tribunëzën, se nuk do ta ndiejë veten mirë, dhe në fakt, sipas porosive, do të japë shpirt pas mesit të natës?

Me gjithë ato histori komplotesh dhe tradhtish, që gjeneronte jeta e udhëheqjes së shtetit shqiptar, unë, tani, e kisha të vështirë të mos u jepja arsye atyre që po shqetësoheshin për efektin që do të bënte lajmi i humbjes së madhe.

Nuk arrita ta ndieja lirshëm veten me një individ që m'u gjend nëpër këmbë ato ditë. Nuk u përshtata dot me të. I gjeta telat, me Vejushën, i gjeta me Telon, me doktorët, me shoferët dhe me ushtarët e gardës, por me dublantin e Komandantit nuk u përshtata, që nuk u përshtata dot. Them, për ato pak orë, që ndenja me të. Përvullësia e tij më vinte në një gjendje të trazuar, sikur diçka mungonte mes nesh. Sapo unë bëhesha gati për t'i ofruar ndonjë lëng të ftohtë nga frigoriferi, ai sikur m'i parablinte mendimet:

“Na u tha goja. A do ndonjë gjë për të pirë?”

“Jo, faleminderit”, i thosha unë me një respekt që më dilte jashtë vullnetit tim. “Mos lëviz, se vete e marr unë.”

“Pu-pu-pu!” ma bënte shëmbëlltyra e Komandantit. “Ta marrësh ti?! Si ta nxë goja!”

Kërcente nga karrigia dhe me një shkathtësi të habitshme gjendej te dera e frigoriferit. Ishte gati t'u shërbente të gjithëve: Telos, Skënderit dhe kujtdo që kish lejen të hynte aty. Ata të gjithë, pa përjashtim, ishin përshtatur me të. E dinin që ai nuk vlente më shumë se një mjet pune dhe e përbuznin. Por, ja, unë e kisha të vështirë.

Ama, nga ana tjetër, nuk e pata të vështirë detyrën me portretin e tij. I shtrova mbi fytyrë një ton të zbehtë, i errësova disi faqet dhe tëmthat, duke ndritur më shumë mollëzat dhe çipat e ballit. Duke punuar kisha parasysh



fytyrën e të vdekurit që kishim në dhomën tjetër dhe nisa të udhëhiqesha më shumë nga përfytyrimi i freskët i saj. Pata kërkuar të dija se si do të ishte ndriçimi në tribunën portative: më thanë që aty nuk do të kishte pothuajse aspak dritë. Teloja më pat thënë, se për çdo të papritur, nuk bëja keq, që edhe unë, të endesha aty rreth tribunës dhe në mbrëmje pata rast ta vërtetoj atë që ndriçimi ishte mbajtur vërtet afër zeros.

Kjo, pra, ma pat lehtësuar punën me sozinë. Më tërhoqi vëmendjen një lloj ekzeme, që njeriu me të cilin po punoja kishte nën mjekër. E pyeta se kur i qe shfaqur ajo. Më tha se vuante prej saj që prej tri vjetësh dhe nuk po ia gjente dot shërimin. Ajo e mundonte shumë. Ishte një sëmundje lëkure tipike, nga e cila vuanin përgjithësisht aktorët. Ajo vinte si pasojë e përdorimit të shpeshtë të makijazhit. Nga kjo përgjigje e tij mora dritë për pyetjen time të pathënë, se qyshkur po përdorej ky njeri si dublant për Komandantin. Duhej të ish prej vitesh, përderisa i qe shfaqur ajo ekzemë.

“Kam unë një medikament, mjaft të efektshëm”, i zbulova.

“Vërtet?!” dhe atij i ndritën sytë plot shpresë. “A mund të më japësh pak prej tij?”

“Me kënaqësi”, i thashë.

“Sa kushton?”

“Asgjë. Do të ta jap falas.”

Sytë iu ngrohën nga mirënjohja dhe m'u duk se do t'i shpërthenin lotët. Për një grimëherë pata drojë se kjo do të më dëmtonte punën. Mund të më ndotëte mollëzat e faqeve dhe pas lotëve do të më duhej të merresha përsëri me to.